

## Vendimi islmik mbi horoskopin

Jo vetëm që praktikimi i astrologjisë është haram, por gjithashtu edhe vizitimi dhe dëgjimi i një astrologu, blerja e librave mbi astrologjinë apo leximi i horoskopit personal po ashtu janë të ndaluara.

Meqë astrologjia kryesisht përdoret për parashikimin e së ardhmes, ata që e praktikojnë atë konsiderohen fatthënës [falltarë]. Si pasojë, ai që kërkon horoskopin e tij bie nën vendimin që gjindet në thënien e Pejgamberit [sallallahu alejhi ue selam]: ‘Namazi [ditor] i atij që i afrohet një fatthënësi dhe e pyet atë në lidhje me ndonjë gjë, s’do të pranohet për dyzet ditë dhe netë.’ [Sahi Muslim]

Dënimi në këtë hadith është thjesht vetëm për avitje dhe të bërit pyetje astrologut, edhe nëse personi dyshon lidhur me vërtetësinë e thënies së tij. Nëse personi dyshon në vërtetësinë apo falsitetin e informatës astrologjike, ai dyshon nëse të tjerët e dinë të fshehtë dhe të ardhmen krahas Allahut. Kjo është formë shirku ngase Allahu qartazi thotë: ‘Dhe tek Ai janë çelësat e Gajbit [tërë ajo që është e fshehur], askush se di atë pos Tij dhe Ai di për çdo gjë që gjindet në [apo mbi] tokë dhe det; asnjë gjeth nuk bie e Ai të mos e di këtë. Nuk ka grimcë në errësirën e tokës e as ndonjë gjë të njomë apo të thatë, vetëm se është e shkruar në Shënimet e Qarta.’ [6:59]

‘Thuaj: Askush në qiej dhe tokë nuk e di Gajbin [të fshehtë] përveç Allahut, e as që mund ta dinë se kur do të ringjallen.’ [27:65]

Mirëpo, nëse personi beson në parashikimin e horoskopit të tij, qoftë nga një astrolog apo ndonjë shkrim në librat e astrologjisë, ai bie drejtpërdrejt në kufër [mosbesim] siç është thënë nga Pejgamberi [sallallahu alejhi ue selam]: ‘Kushdo që viziton një fatthënës dhe beson në atë çka ai thotë, vetëm se ka mohuar atë që i është zbritur Muhamedit.’ [Sunen Ebu Daud]

Si në hadithin paraprak, hadithi literalisht i referohet fatthënësit por është i aplikueshëm edhe në astrolog. Të dy këta pohojnë dituri për të ardhmen. Pohimi i astrologut është po aq kundërshtues ndaj Teuhidit sa edhe fatthënësi i rëndomtë. Ai pohon se personalitetet e njerëzve janë të përcaktuara nga yjet, dhe se veprat dhe ngjarjet e tyre të ardhshme janë të shkruara në yje. Fatthënësi i rëndomtë pohon se formimi i gjethëve të çajit [apo kafja] në filxhan, apo vijat në pëllëmbë i tregojnë atij gjënë e njëjtë. Në të dy rastet individët pohojnë aftësi në leximin e diturisë së fshehtë të formimit fizik të objekteve të krijuara.

Besimi në astrologji dhe në horoskope është në kundërshtim të qartë me tekstin dhe shpirtin e Islamit. Në të vërtetë, ai që i hulumton këto shtigje është shpirti i zbrazët, i cili nuk e ka shijuar imanin [besimin] e vërtetë. Në thelb, këto rrugë paraqesin një orvatje të kotë për t’i ikur Kadrit [fatit] - besimi injorant se nëse e dinë se çfarë i pret të nesërmën, ata mund të përgatitën që sot, në mënyrë që t’i shmangen së keqes dhe ta sigurojnë të mirën. Sidoqoftë, i Dërguari i Allahut qe udhëzuar nga Allahu që të thotë: ‘Thuaj [O Muhamed]: Unë nuk posedoj ndonjë autoritet mbi dobinë apo dëmin tim, përveç çka do Allahu. Sikur ta dija gajbin [të fshehtë], do të siguroja për vete pasuri me bollëk, dhe kurrfarë e keqe s’do të më ndodhte. Por, unë s’jam tjetër veçse paralajmërues, dhe prurës i lajmeve të gëzueshme për ata që besojnë.’ [7:188]

Prandaj, muslimanët e vërtetë obligohen që të rrinë sa më larg këtyre gjërave. Pra, unazat, zingjirët, etj., që kanë shenja të Zodiakut<sup>1</sup> në to s’duhet të mbarten, edhe nëse nuk keni besim në to. Ato janë pjesë e një sistemi të fabrikuar i cili propagon kufër dhe i duhet dhënë fund krejtësisht. Asnjë musliman s’duhet të tentojë që ta qëllojë shenjën e tij, e as që ai ose ajo duhet të lexojnë rubrikat e horoskopit në gazeta apo të dëgjojnë leximin e tyre. Dhe, cilido musliman që lejon parashikimin astrologjik për të përcaktuar punën e tij, duhet të kërkojë falje prej Allahut dhe ta përtërijë Islamit e tij.